

Formular për SYLLABUS të Lëndës

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	Fakulteti Juridik
Titulli i lëndës:	Financat dixhitale
Niveli:	Master
Statusi lëndës:	Zgjedhore
Viti i studimeve:	Viti I, Semestri II
Numri i orëve në javë:	2+0
Vlera në kredi – ECTS:	4
Koha / lokacioni:	Salla A3
Mësimdhënësi i lëndës:	Prof.Ass.Dr. Artor Nuhiu
Detajet kontaktuese:	artor.nuhiu@uni-pr.edu
Përshkrimi i lëndës	
	<i>Lënda synon të i'u mundësojë studentëve të kuptojnë se si teknologjia po transformon kornizën e zhvillimit të sistemit financiar dhe ligjor përmes analizës së financave dixhitale, modeleve të reja të ndërmjetësimit financiar, rolit inovativ të teknologjisë Blockchain, Inteligjencës Artificiale (AI), tokenizimit dhe analitikës së të dhënave të mëdha në sektorin financiar, si dhe të identifikojnë kuadrin ligjor të zbatueshëm për aktivitetet e ndryshme dhe çështjet ligjore të ngritura në këtë kontekst. Studentët do të jenë në gjendje të menaxhojnë transformimin dixhital të epokës së teknologjisë financiare (FinTech) nga këndvështrime të ndryshme, falë edhe një qasjeje ndërkombëtare dhe shumëdimensionale. Lënda përcakton aspektet e botës së financave dixhitale me një fokus të veçantë në financat e korporatave, aspektet kritike, rreziqet si dhe përfitimet e qenësishme të zbatimit të financave dixhitale në bazë të sistemeve aktuale financiare dhe ligjore, si në nivel kombëtar ashtu edhe ndërkombëtar si dhe perspektivat e ardhshme.</i>
Qëllimet e lëndës:	<i>Qëllimi i lëndës është të ndërgjegjësojë studentët për ndryshimet dhe sfidat e rëndësishme që nënkupton dixhitalizimi për mirëfunksionimin e tërë sistemit financiar dhe funksionit financiar të ekonomisë. Në mjedisin e sotëm dixhital me zhvillim të shpejtë, të zgjidhjeve të reja dhe inovative është e domosdoshme absorbimi i njohurive dhe të kuptuarit e përfitimeve të plota nga përdorimi i këtyre teknologjive dhe mjedisit të financave dixhitale. Kjo lëndë eksploron njohuritë dhe aftësitë e nevojshme për të kuptuar dhe lundruar në botën komplekse të financave dixhitale dhe të aplikuarit</i>

	<i>e teknologjive në zhvillim në një kontekst të botës reale. Më konkretisht, lënda diskuton temat e ekosistemit të financave dixhitale; e ardhmja e parave dixhitale; teknologjia dhe përdorimi i saj në financa; analiza, interpretimi dhe vizualizimi i të dhënave; dhe menaxhimin e rrezikut, qeverisjen dhe rregullimin.</i>
--	-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------

Rezultatet e pritura të nxënies:	<p><i>Pas përfundimit të kësaj lënde, studentët do të fitojnë njohuri dhe aftësi të:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> • <i>Shqyrtojnë se ku jemi sot dhe ku do të jemi në të ardhmen e afërt, me teknologjitë e përdorura në mjedisin e financave dixhitale si FinTech, pagesat dixhitale dhe monedhat dixhitale, Inteligjenca Artificiale (AI), Automatizimi i Procesit Robotik (RPA), të dhënat e mëdha.</i> • <i>Kuptojnë zhvillimet e fundit të teknologjisë financiare (FinTech) dhe të analizoj ndikimin e tyre në industrinë e shërbimeve financiare.</i> • <i>Kuptojnë teknologjitë që qëndrojnë në themel të kriptovalutave dhe blockchains.</i> • <i>Zbatojnë njohuritë për të përkthyer koncepte dhe terminologji komplekse të financave dixhitale për të mbështetur vendimmarrjen strategjike të informuar rreth përdorimit të teknologjive kryesore të financave dixhitale në biznes.</i> • <i>Përdorin njohuritë në teknologjitë e financave dixhitale për të lundruar në mjedisin teknologjik në ndryshim.</i> • <i>Shqyrtojnë implikimet rregullatore dhe organizative të teknologjive dixhitale dhe se si ato mund të zbatohen në një sërë mjedisesh, duke përfshirë pajtueshmërinë në kontekstet organizative dhe rregullative.</i>
-----------------------------------------	-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------

Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënës të studentit)			
Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithësej
Ligjërata	2	15	30
Ushtrime teorike/laboratorike			
Punë praktike			
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	2	15	30
Ushtrime në teren			
Kollokfiime,seminare	1	2	2
Detyra të shtëpisë			
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	4	4	16

Përgaditja përfundimtare për provim	6	2	12
Koha e kaluar në vlerësim (teste,kuiz,provim final)	5	2	10
Totali			100 orë
Metodologjia e mësimdhënies:	<p>Lënda do të organizohet në formë të ligjeratave, diskutimeve dhe konsultimeve. Studentët duhet të jenë pjesëmarrës aktivë të procesit mësimor.</p> <p>Mësimi aktiv kërkon që studentët të reflektojnë mbi gjërat që diskutohen e jo të jenë pranues pasivë të informatave që u jepen. Ata janë të inkurajuar që të shtrojnë pyetje. Nga studentët paraprakisht do të kërkohet leximi dhe thellimi në literaturën relevante për temat e specifikuar të lëndës.</p>		
Metodat e vlerësimit:	<p>Vlerësimi i studentëve konsiston në dy metoda:</p> <p>1. Vlerësimi i vazhdueshëm: Studentët do të vlerësohen gjatë gjithë semestrit përmes:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ <u>Vlerësimi fundsemestral përmes testit: 90%</u> ▪ <u>Pjesëmarrja e rregullt në ligjërata, angazhimi në diskutime dhe prezantimi: 10%.</u> <p>2. Provimi final: Studentët që nuk kanë arritur të kalojnë me sukses vlerësimin e vazhdueshëm ose nuk kanë marrë pjesë në të, duhet t'i nënshtrohen provimit final gjatë afatit të provimeve.</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ <u>Provimi final: vlerësohet me 100%.</u> <p>Shënim: Studentët që zgjedhin/kalojnë me sukses vlerësimin e vazhdueshëm dhe janë të kënaqur/pranojnë notën e kollokfiumit lirohen nga pjesëmarrja në provimin final.</p>		
Literatura			
Literatura bazë:	<ol style="list-style-type: none"> 1. Ligjërata të autorizuara – Financat Dixhitale, Universiteti i Prishtinës - Fakulteti Juridik, Prishtinë, 2023. 2. Baxter Hines, Digital Finance: Security Tokens and Unlocking the Real Potential of Blockchain, 2020. 3. Perry H. Beaumont, Digital Finance: Big Data, Start-ups, and the Future of Financial Services, 2021. 4. Group of authors, Digital Finance / La finance numérique, 2016. 5. Group of authors, Digital Finance in Europe: Law, Regulation, and Governance, 2022. 		
Literatura shtesë:	<ol style="list-style-type: none"> 1. Eswar S. Prasad, The Future of Money: How the Digital Revolution Is Transforming Currencies and Finance, 2021. 2. Susanne Chishti & Janos Barberis, The FINTECH Book: The Financial Technology Handbook for 		

	<p><i>Investors, Entrepreneurs and Visionaries, 2016.</i></p> <p>3. <i>Chris Skinner, Digital Bank: Strategies to Launch or Become a Digital Bank, 2014.</i></p> <p>4. <i>Paul Vigna & Michael J. Casey, The Age of Cryptocurrency: How Bitcoin and Digital Money Are Challenging the Global Economic Order, 2015.</i></p>
Plani i dizajnuar i mësimi:	
Java	Ligjerata që do të zhvillohet
Java e parë:	Ligjëratë hyrëse - prezantimi i syllabusit të lëndës
Java e dytë:	Hyrje në FinTech; Roli i financave në ekonomi; Roli i ndërmjetësve financiarë
Java e tretë:	Evolucioni teknologjik; Ndikimi i teknologjisë në mjedisin e financave dixhitale; Ndikimi i teknologjisë në tregjet bankare dhe financiare.
Java e katërt:	Dixhitalizimi i sistemit të pagesave; Evolucioni historik i sistemit të pagesave; Atributet e një sistemi pagesash mirëfunksional; Bankat si garantues të sistemit të pagesave; Hyrësit e rinj dhe modelet e reja të pagesave: rreziqe për sistemin bankar.
Java e pestë:	Çështjet e sigurisë në sistemet e reja të pagesave; Përgjigja rregullatore: PSD2 (Direktiva 2 për shërbimet e pagesave) dhe SEPA (Zona e përbashkët evropiane e pagesave).
Java e gjashtë:	Paratë dhe monedhat; Paratë dixhitale; Bitcoin dhe blockchains; Funkzioni ekonomik i monedhës në ekonomi; Problemet me besueshmërinë e emetuesit; Analiza e bitcoin si monedhë; Blockchain si një mekanizëm regjistrimi.
Java e shtatë:	Integrimi i bitcoin dhe blockchain dhe problemet e nxitjes së emetuesit; Përdorimet e mundshme alternative të teknologjisë blockchain në ekonomi dhe vështirësitë në zbatimin e saj; Përdorimi i bitcoin në pastrimin e parave; Trajtimi rregullator.
Java e tetë:	FinTech - analitika e të dhënave të mëdha dhe modele të reja në biznes; Përdorimi i të dhënave në vendimarrjet tradicionale; Kombinimi i të dhënave të mëdha dhe mësimi të makinerive për të përmirësuar vendimarrjet në biznes
Java e nëntë:	Llogaritë e zgjuara (smart accounts), produktet financiare të personalizuar, menaxhimi i rrezikut dhe parandalimi i mashtrimit.
Java e dhjetë:	Çfarë janë financat alternative? Kreditimi alternativ; Financimi alternativ; E ardhmja e bankingut.
Java e njëmbëdhjetë:	Bazat e automatizimit; Vlera e automatizimit; Planifikimi për sukses; Bazat e inteligjencës artificiale (AI); Përfitimet nga AI; Rreziqet dhe sfidat në përdorimin e AI.
Java e dymbëdhjetë:	Hyrje në të dhënat e mëdha; Strategjia e të dhënave: Pse një biznesi ka nevojë për strategji të dhënash; Korniza për hartimin e një strategjie efektive të të dhënave; Zbatimi i strategjisë së të dhënave.
Java e trembëdhjetë:	Siguria dixhitale; Sfida e sigurimit të konfidencialitetit, integritetit dhe të disponueshmërisë; Letrat me vlerë dixhitale si një rrezik i ri

	sistematik në ekonomi; Rregullativa për sigurinë kibernetike.
Java e katërbëdhjetë:	Rregullativa për FinTech; Pse ndodh rregullimi? Çfarë do të thotë për një kompani FinTech që operon në një mjedis global? Bazat e teknologjisë rregullatore (RegTech); Përgatitja për RegTech.
Java e pesëmbëdhjetë:	Vlerësimi fundsemestral përmes testit
Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:	
<p>Sjelljet e poshtëshënuara janë në kundërshtim me politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Vonesa në ligjerata dhe ushtrime; • Lëshimi i sallës gjatë ligjeratave ose ushtrimeve (pa arsyeje të nevojshme); • Tregimi i shenjave të qarta të mosinteresimit dhe të folurit të pandërprerë ose formave tjera të sjelljes që pengojnë procesin e rregullt të mësimit; • Mbajtja e telefonit celular të hapur gjatë ligjeratave ose ushtrimeve, do të rezultojnë me humbje të pikëve për shkak të sjelljes joprofesionale. <p>Shkelja e integritetit akademik përfshin një ose më shumë nga veprimet në vijim:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Kopjimi gjatë provimit ose testit; • Shfrytëzimi i shenimeve ose librave të palejuara gjatë testit ose provimit; • Shkëmbimi i informatave me një student tjetër gjatë provimit; • Dhënja e deklaratave të rrejshme për të arsyetuar dikë nga mësimi, ushtrimi apo provimi. 	